

VENDIM

Nr. 956, datë 7.12.2016

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË DETAJEVE TË FORMULËS SË UNIFIKUAR TË PIKËZIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia dhe dhuratat.
2. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuar nga INSTAT-i, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 dhjetor 2016.

KRYEMINISTRI

Edi Rama